



FLETORJA ZYRTARE E REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Botim i Qendrës së Publikimeve Zyrtare

www.qpz.gov.al

Nr.53

7 maj

2011

P Ë R M B A J T J A

		Faqe
Vendim i KM nr.237, datë 23.3.2011	Për miratimin e rregullores “Për administrimin e zonës arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit”.....	2251
Vendim i KM nr.238, datë 23.3.2011	Për shpalljen e qendrës historike të qytetit të Korçës dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj.....	2255
Vendim i KM nr.262, datë 6.4.2011	Për një shtesë fondi në buxhetin e vitit 2011, miratuar për Ministrinë e Shëndetësisë, për mbulimin e shpenzimeve të kurimit të z.Roland Trebicka, në Francë.....	2260
Vendim i KM nr.263, datë 6.4.2011	Për disa shtesa në vendimin nr.759, datë 15.9.2010 të Këshillit të Ministrave “Për kuotat financiare të ushqimit në mensa e konvikte, bursat e shtetit dhe pagesat e nxënësve dhe të studentëve në institucionet arsimore publike, për vitin shkollor 2010-2011”, të ndryshuar.....	2260
Vendim i KKRT nr.87, datë 28.3.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv ARV”.....	2261
Vendim i KKRT nr.88, datë 28.3.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv 4+”.....	2261
Vendim i KKRT nr.89, datë 28.3.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Mati”.....	2262
Vendim i KKRT nr.90, datë 28.3.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Kruja”.....	2262
Vendim i KKRT nr.91, datë 28.3.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Tv Berati”.....	2262

Vendim i KKRT nr.92, datë 28.3.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat vendor “Club Tv”	2263
Vendim i KKRT nr.93, datë 28.3.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “Tv kabllor ANI”	2263
Vendim i KKRT nr.94, datë 28.3.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “Tv kabllor Egnatia”	2264
Vendim i KKRT nr.95, datë 28.3.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “Tv kabllor Elbasat”	2264
Vendim i KKRT nr.96, datë 28.3.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “Tv kabllor Bulqiza”	2264
Vendim i KKRT nr.97, datë 28.3.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “Tv kabllor Kukësi”	2265
Vendim i KKRT nr.98, datë 28.3.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “Tv kabllor Kuçova”	2265
Vendim i KKRT nr.99, datë 28.3.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “Tv kabllor Mati”	2266
Vendim i KKRT nr.100, datë 28.3.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “Tv kabllor HB-CA”	2266
Vendim i KKRT nr.101, datë 28.3.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “Tv kabllor Asparag”	2266
Vendim i KKRT nr.102, datë 28.3.2011	Për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Magic Star”	2267
Vendim i KKRT nr.103, datë 28.3.2011	Mbi mosrinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Lezha”	2267
Vendim i KKRT nr.104, datë 28.3.2011	Mbi mosrinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “Tv kabllor Përmeti”	2269
Vendim i KKRT nr.105, datë 28.3.2011	Mbi mosrinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “Tv kabllor AL-TE”	2271
Vendim i KKRT nr.109, datë 28.3.2011	Për dhënie licence personit fizik z.Shaban Merkaaj, për televizionin privat kabllor “Tv kabllor Lapardha”	2272
Vendim i KKRT nr.110, datë 28.3.2011	Për dhënie licence personit fizik z. Vullnet Nazëraj, për televizionin privat kabllor “Tv kabllor ARD&NET”	2272
Vendim i KKRT nr.111, datë 28.3.2011	Për dhënie licence personit fizik z. Gjergj Gega, për televizionin privat kabllor “Tv kabllor Mamurras”	2273

Vendim i KKRT nr.112, datë 28.3.2011	Për dhënie licence personit fizik znj.Ëngjëllushe Veliaj, për televizionin privat kabllor “Tv kabllor Oreh”.....	2273
Vendim i KKRT nr.113, datë 28.3.2011	Për dhënie licence personit fizik z.Bilbil Hajdini, për televizionin privat kabllor “Tv kabllor Alfa Hajdini”.....	2274
Vendim i KKRT nr.114, datë 28.3.2011	Për zgjerimin e zonës së licencimit për televizionin privat kabllor “Tv kabllor Xhaçi”.....	2275
Vendim i KKRT nr.115, datë 28.3.2011	Për dhënie licence personit fizik z.Gëzim Cake, për televizionin privat kabllor “Tv kabllor Zargoçan”.....	2275
Vendim i KKRT nr.116, datë 28.3.2011	Për dhënie licence personit fizik z.Arben Asllani, për televizionin privat kabllor “Tv kabllor 2ASL”.....	2276
Vendim i KKRT nr.117, datë 28.3.2011	Për dhënie licence personit fizik z.Fredi Hasa, për televizionin privat kabllor “Tv kabllor Pìrg”.....	2276
Vendim i KKRT nr.118, datë 28.3.2011	Për dhënie licence personit fizik z.Adem Boriçi, për televizionin privat kabllor “Tv kabllor Brado”.....	2277
Vendim i KKRT nr.119, datë 28.3.2011	Për dhënie licence shoqërisë “Masa Grup 2009” sh.p.k. për televizionin privat kabllor “Tv kabllor Masa Grup”.....	2277
Vendim i KKRT nr.120, datë 28.3.2011	Për dhënie licence për radion private vendore “ABC News”....	2278
Vendim i KKRT nr.121, datë 28.3.2011	Për dhënie licence për radion private vendore “Radio Epiri 2011”.....	2278
Vendim i KKRT nr.122, datë 28.3.2011	Për zgjerimin e zonës së licencimit, shoqërisë “MRM” sh.p.k., për televizionin privat kabllor “Tv kabllor Korça”.....	2279
Vendim i KKRT nr.123, datë 28.3.2011	Mbi shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Fokus Cable” sh.p.k.....	2279
Vendim i KKRT nr.138, datë 28.3.2011	Mbi pavlefshmërinë e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Armonia”.....	2281
Vendim i KKRT nr.139, datë 28.3.2011	Mbi pavlefshmërinë e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Prespa”.....	2282
	Vendim për shpalljen të vdekur të shtetasit Ilir Driza.....	2283

VENDIM
Nr.237, datë 23.3.2011

**PËR MIRATIMIN E RREGULLORES “PËR ADMINISTRIMIN E ZONËS
ARKEOLOGJIKE “A” DHE “B” TË QYTETIT TË DURRËSIT”**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të nenit 30 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Miratimin e rregullores “Për administrimin e zonës arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit”, sipas tekstit dhe hartës bashkëlidhur këtij vendimi.
2. Në pikën 1 të vendimit nr.6, datë 7.1.2005 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e zonave arkeologjike brenda qendrave të banuara Shkodër, Lezhë, Krujë, Durrës, Elbasan, Berat, Vlorë, Sarandë”, të ndryshuar, zonifikimi për qytetin e Durrësit shfuqizohet.
3. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, bashkia e Durrësit dhe institucionet e specializuara për zbatimin e këtij vendimi.
Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
**PËR ADMINISTRIMIN E ZONËS ARKEOLOGJIKE “A” DHE “B” TË QYTETIT TË
DURRËSIT**

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore ka për qëllim përcaktimin e rregullave për administrimin e zonës arkeologjike “A” dhe “B” të qytetit të Durrësit, mbështetur në ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore” të ndryshuar.

Neni 2
Ndërhyrjet në zonën arkeologjike “A” të qytetit të Durrësit

Në zonën arkeologjike “A” të qytetit të Durrësit lejohet:

1. Restaurimi dhe konservimi i monumenteve dhe strukturave arkeologjike, kryerja e sondazheve arkeologjike me synimin studimin e plotë të zonës, mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve.
2. Rikonstruksioni i rrugëve dhe të gjitha punimet në rrjetin inxhinierik ujësjellës-kanalizime, ndriçim, telefoni, mbi bazën e projekteve të miratuara nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve. Për të gjitha ndërhyrjet e mësipërme realizohet mbikëqyrje arkeologjike në mënyrë të vazhdueshme gjatë zbatimit të punimeve nga specialistët e Agjencisë së Shërbimeve Arkeologjike.
3. Vendosja e konstruksioneve të lehta, dru, xham, plastikë, metal me lartësi maksimale 3m, të cilat duhen realizuar larg mureve dhe strukturave të tjera të dallueshme apo të supozuara. Konstruksionet vendosen dhe përdoren nga institucionet shtetërore të specializuara, duhet të jenë të lëvizshme dhe që në asnjë rast nuk dëmtojnë nëntokën dhe peizazhin, në funksion të ruajtjes,

ekspozimit, informimit publik dhe nevojave të tjera që lidhen me veprimtarinë arkeologjike në veçanti dhe trashëgiminë kulturore në përgjithësi.

4. Projekti miratohet nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë dhe Këshilli Kombëtar i Restaurimeve dhe për çdo rast duhet të përcaktojë saktësisht qëllimin, kohëzgjatjen, vendndodhjen e strukturës brenda zonës, si dhe planprojektin e saj.

Neni 3

Ndërhyrjet në zonën arkeologjike “B” të qytetit të Durrësit

Në zonën arkeologjike “B” të qytetit të Durrësit përveç ndërhyrjeve që lejohen në zonën arkeologjike “A”, lejohen edhe:

1. Ndërtimet e reja pas miratimit me shkrim nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë të kërkesave të subjekteve të interesuara.

2. Ndërtimet lejohen vetëm pas kryerjes paraprake nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik të vëzhgimit intensiv, sondazheve arkeologjike apo formave të tjera të testimit në varësi të potencialit që përfaqëson zona me miratim të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë.

3. Format e testimit përcaktohen nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, por kryesisht janë sondazhe që nuk cenojnë shtresat në rast të vijimit të gërmimit arkeologjik, studime gjeofizike, regjistrim digjital i terrenit, vëzhgim intensiv arkeologjik.

Investitori, përveç sondazheve arkeologjike, është i detyruar të ndërmarrë edhe prova me karrotazh, sipas përcaktimeve në kontratën dypalëshe me Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik.

4. Në rastet kur gjatë zbatimit të projektit ndërtimor zbulohen gjetje të rëndësishme të veçantë, projekti duhet të rishikohet. Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë miraton ndryshimet në projekt, duke marrë në konsideratë konservimin, ruajtjen, si dhe bërjen e tyre të vizitueshme. Vetëm pas miratimit të ndryshimeve lejohet vazhdimi i punimeve.

Neni 4

Procedurat që ndiqen për ndërhyrjet ndërtimore në zonën arkeologjike “B”

1. Për çdo ndërhyrje, në zonat arkeologjike “B”, subjekti ndërtues i interesuar vë në dijeni Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare përgjegjëse për qytetin e Durrësit dhe paraqet pranë Sekretarisë Teknike të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë dokumentacionin si më poshtë:

- Fotokopje e noterizuar e lejes së sheshit të ndërtimit nga KRRT/KRRTRSH;

- Fotokopje e noterizuar e vendimit të Gjykatës ose regjistrimit në Qendrën Kombëtare të Regjistrimit;

- Prokurë për personin e autorizuar për nënshkrimin e kontratës nëse nuk është administrator i subjektit;

- Projektin ndërtimor, planimetri, prerje themelesh, fasadë.

2. Pas shqyrtimit dhe miratimit të kërkesës së subjektit nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik nënshkruan një kontratë me subjektin për zbatimin e procedurës, si dhe përcaktimin e të drejtave dhe detyrimeve.

Neni 5

Ndërhyrjet pa leje në zonën arkeologjike “B”

1. Për ndërhyrjet pa leje brenda zonës arkeologjike “B”, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare përgjegjëse për qytetin e Durrësit pezullon menjëherë veprimtarinë e subjektit dhe njofton Agjencinë e Shërbimit Arkeologjik dhe strukturën përgjegjëse për trashëgiminë kulturore në Ministrinë e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Në rast se subjekti nuk pezullon veprimet brenda 24 orëve, Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare përgjegjëse për qytetin e Durrësit i drejtohet menjëherë Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Vendor dhe Inspektoratit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar për pezullimin e ndërtimit deri në prishjen e tij.

Neni 6

Shkelje e procedurave nga subjekti ndërtues

Në rast të shkeljeve të procedurave nga subjektet ndërtimore, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë për subjektin, si dhe për drejtuesin teknik përkatës, nuk merr në shqyrtim për një periudhë 3-vjeçare asnjë kërkesë për ndërtim në zona arkeologjike “B” në të gjithë territorin e vendit, apo në zona të tjera, ku sipas ligjit kërkohet miratimi i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë.

Neni 7

Gjetjet arkeologjike

1. Klasifikohen si vlera të rëndësishme objektet e luajtshme dhe të paluajtshme në kontekstet arkeologjike, struktura murale, varre monumentale, pjesë mozaiku të shtrirë në një sipërfaqe mbi 4 m², afreske, ndërtime inxhinierike, pjesë arkitekturore që lidhen me strukturat murale dhe banesa, tempuj e godina të tjera shërbimesh.

2. Në rast gjetjesh të rëndësishme të paluajtshme, punimet e nisura pezullohen menjëherë nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik. Brenda afatit prej 10 ditësh nga ndërprerja e punimeve, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë vendos për veprimet e mëtejshme. Veprimet e mëtejshme në lidhje me vazhdimin e ndërtimit do të ndërmerren nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik në cilësinë e Sekretarisë Teknike të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, jo më vonë se 30 ditë nga ndërprerja e punimeve. Nëse gjetjet janë me vlera të rëndësishme, punimet e filluara të ndërpriten përfundimisht. Vendimi në këtë rast merret nga organi që ka autorizuar fillimin e punimeve, Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë.

3. Në rast se Agjencia e Shërbimit Arkeologjik i propozon ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore shpalljen monument kulture të një objekti të paluajtshëm, Instituti i Monumenteve të Kulturës bën studimin e zonës mbrojtëse të saj brenda 30 ditëve nga zbardhja e vendimit për shpalljen monument kulture.

4. Shpenzimet për kryerjen e hulumtimeve të nevojshme, përgatitjen e dokumentacionit, si dhe për ndryshimet e mundshme të projektit kur vendoset që gjetjet të mbrohen në vend *in situ*, të gjitha shpenzimet për to, si dhe shpenzimet për kërkimet shkencore, veprimtaritë e nevojshme restauruese ose konservuese mbulohen 100% nga investitori.

5. Në rast të gjetjeve arkeologjike të rëndësishme, kur Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë vendos ndërprerjen përfundimtare të punimeve, investitori shpronësohet në bazë të kuadrit ligjor në fuqi.

Neni 8

Gërmimet e shpëtimit

1. Në rast gjetjesh arkeologjike të rëndësishme, zhvillohet gërmim i shpëtimit. Gërmimi i shpëtimit kryhet nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik ose nga subjekte private me leje të Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë, nën mbikëqyrjen e Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.

2. Në rast se gjatë kryerjes së gërmimit të shpëtimit gjykohet e nevojshme asistencë shkencore dhe teknike në terren e specialistëve të Institutit të Arkeologjisë, kërkohet zyrtarisht pjesëmarrja e tyre në gërmim.

3. Nëse pas kryerjes së gërmimit të shpëtimit zbulohen gjetje të rëndësishme të veçantë, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik pezullon gërmimin dhe propozon në Këshillin Kombëtar të Arkeologjisë ndryshimet në projekt, me synim mbrojtjen dhe bërjen të vizitueshme të këtyre vlerave.

4. Vazhdimi i punimeve ndërtimore lejohet mbas verifikimit nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik të përmbushjes së kriterëve të vendosura nga Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë për zbatimin korrekt të projektit të mbrojtjes dhe vizitueshmërisë.

5. Në përfundim të çdo gërmimi shpëtimi përgatitet një relacion i plotë, i cili i paraqitet

Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë për miratim brenda 30 ditëve. Pas shqyrtimit dhe miratimit, një kopje e relacionit të plotë depozitohet edhe pranë Institutit të Arkeologjisë.

6. Në rastin kur gërmimi i shpëtimit kryhet nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, relacioni firmoset nga drejtuesi i grupit dhe nga anëtarët e tij, si dhe konfirmohet nga drejtori i Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik.

7. Në rastin kur gërmimi i shpëtimit kryhet nga një subjekt privat, relacioni firmoset/konfirmohet nga drejtuesi i projektit të subjektit, minimum 2 arkeologë të këtij subjekti dhe nga specialisti i autorizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik, i cili ka qenë prezent gjatë gërmimit.

Neni 9

Gërmimet arkeologjike

1. Vëzhgimi intensiv sipërfaqësor dhe sondazhet arkeologjike kryhen nga specialistë të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik. Në çdo projekt të ndërmarrë nga subjektet, është e detyrueshme pjesëmarrja e një përfaqësuesi të autorizuar nga Agjencia e Shërbimit Arkeologjik.

2. Kur subjekti privat kryen shkelje duke mos respektuar legjislacionin në fuqi, Agjencia e Shërbimit Arkeologjik pezullon gërmimin dhe relaton menjëherë në Këshillin Kombëtar të Arkeologjisë, duke propozuar edhe masat përkatëse. Agjencia e Shërbimit Arkeologjik vulos kantierin dhe e monitoron atë në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare, përgjegjëse për qytetin e Durrësit.

3. Këshilli Kombëtar i Arkeologjisë, pasi shqyrton rastin, vendos:

a) Lënien në fuqi të vendimit të Agjencisë së Shërbimit Arkeologjik për pezullimin e punimeve;

b) Shfuqizimin e vendimit për pezullimin dhe lejimin e vijimit të punimeve.

4. Në rastet kur subjekti privat nuk e kryen gërmimin sipas kuadrit ligjor në fuqi, Këshilli Kombëtar Arkeologjik i delegon Agjencisë së Shërbimeve Arkeologjike të vazhdojë gërmimet.

5. Vendimi i Këshillit Kombëtar të Arkeologjisë është i formës së prerë.

Neni 10

Vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese

1. Në zonën arkeologjike “A” dhe “B” vendosja e tabelave prezantuese dhe paneleve shpjeguese për monumente të veçanta, rrënoja apo hapësira me potencial arkeologjik, bëhet vetëm në vendet e përcaktuara sipas rastit nga Instituti i Monumenteve të Kulturës dhe Agjencia e Shërbimeve Arkeologjike, dhe zbatohet nga Drejtoria Rajonale e Kulturës Kombëtare përgjegjëse për qytetin e Durrësit.

2. Në asnjë rast tabelat prezantuese dhe panelet shpjeguese nuk duhet të dëmtojnë apo konkurrojnë monumentin.

3. Vendosja e tabelave të sinjalistikës rrugore/turistike pranë monumenteve dhe zonave të mbrojtura rreth tyre bëhet në mbikëqyrjen e Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare përgjegjëse për qytetin e Durrësit.

4. Për çdo veprimtari me karakter kulturor në zonat arkeologjike “A” dhe “B”, vendosja e tabelave dhe e materialeve publicitare lejohet në raste të veçanta festivo-kulturore dhe ka karakter të përkohshëm. Vendosja e tyre ekzekutohet vetëm në zbatim të urdhrit të ministrit përgjegjës për trashëgiminë kulturore dhe nën mbikëqyrjen e Drejtorisë Rajonale të Kulturës Kombëtare përgjegjëse për qytetin e Durrësit.

5. Është e ndaluar vendosja e posterave publicitarë, jokulturorë dhe politikë, si dhe dëmtimet e tjera të monumenteve dhe rrënojave arkeologjike, vizatimi, shkrimi mbi strukturat e paluajtshme.

Neni 11
DISPOZITA TË FUNDIT

Kjo rregullore shoqërohet me hartën e zonifikimit, e cila rishikohet periodikisht nga Këshilli Kombëtar Arkeologjik bazuar në të dhënat e reja arkeologjike, si dhe nevojën për mbrojtjen e monumenteve.

Neni 12

Në studimet urbanistike për qytetin e Durrësit duhet të merret parasysh zonifikimi arkeologjik i qytetit të Durrësit dhe përcaktimet e kësaj rregulloreje.

Studimet urbanistike të miratuara që janë në fazën e implementimit, si dhe rregulloret përkatëse të tyre duhet të rishikohen nga Këshilli Kombëtar Arkeologjik, me qëllim që të zbatohet zonifikimi arkeologjik i qytetit të Durrësit dhe përcaktimet e rregullores përkatëse.

Neni 13

Kësaj rregulloreje i bashkëlidhet:

Harta e zonifikimit arkeologjik e qytetit të Durrësit me koordinatat përkatëse gjeografike të marra me GPS (garmin 60).

VENDIM
Nr.238, datë 23.3.2011

**PËR SHPALLJEN E QENDRËS HISTORIKE TË QYTETIT TË KORÇËS DHE
MIRATIMIN E RREGULLORES PËR ADMINISTRIMIN E SAJ**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikave 3 e 4 të nenit 29 të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, me propozimin e Ministrit të Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Shpalljen e qendrës historike të qytetit të Korçës dhe miratimin e rregullores për administrimin e saj, sipas tekstit dhe hartës që i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Ngarkohen Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, bashkia e Korçës dhe institucionet e specializuara për zbatimin e këtij vendimi.

3. Vendimi nr.455, datë 23.6.2005 i Këshillit të Ministrave “Për shpalljen “Qendër historike” dhe “Ansambël urbanistik, arkitektonik, tradicional” të disa zonave të qytetit të Korçës, si dhe për miratimin e rregullores së administrimit të tyre”, shfuqizohet.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

RREGULLORE
PËR SHPALLJEN E QENDRËS HISTORIKE TË QYTETIT TË KORÇËS DHE MIRATIMIN E
RREGULLORES PËR ADMINISTRIMIN E SAJ

Neni 1
Qëllimi

Kjo rregullore përcakton detyrimet dhe mënyrat për mbrojtjen, konservimin e integruar dhe administrimin e vlerave historiko-kulturore të qendrës historike dhe ansamblit urban rreth saj (zonës së mbrojtur) të qytetit të Korçës.

Kjo rregullore mbështetet në ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar dhe vendimin e Këshillit të Ministrave nr.426, datë 13.7.2007 “Për miratimin e Kartës Shqiptare të Restaurimit”.

Neni 2

Struktura e hapësirës urbane me vlera historiko-kulturore të qytetit të Korçës

Hapësira urbane me vlera historiko-kulturore e qytetit të Korçës, formohet prej qendrës historike, ansamblit urban rreth saj (zonës së mbrojtur) dhe një zone me potencial arkeologjik të kategorisë B.

1. Qendra Historike e Korçës përfshin:

a) Ansamblin mbi përmendoren e “Luftëtarit të Panjohur” në lagjen nr.3, përfshirë dhe radhën e parë të ndërtimeve buzë rrugicave kufizuese të ansamblit;

b) Ansamblin e Pazarit të Vjetër të qytetit, i cili përfshin edhe territorin përreth xhamisë së Iliaz Mirahorit;

c) Ansamblin, pjesë përbërëse e lagjes nr.12, përfshirë dhe radhën e parë të ndërtimeve buzë rrugicave kufizuese të ansamblit;

d) Ansamblet që shtrihen në të dyja anët e bulevardit “Republika”.

2. Ansambli urban (zona e mbrojtur) përfshin pjesë të lagjeve nr.1,2,3,11,12.

3. Zona me potencial arkeologjik, pjesë e ish-lagjes “Kala” dhe zona pas bankës.

Kufijtë e qendrës historike, ansamblit urban (zona e mbrojtur) dhe zonave me potencial arkeologjik paraqiten në hartën e zonifikimit të qytetit të Korçës, e cila është pjesë e kësaj rregulloreje.

Neni 3

Qendra historike

Qendra historike e Korçës është hapësira me vlera të rëndësishme urbanistiko-arkitekturore që dokumenton rrugën e zhvillimit historik të qytetit të Korçës dhe arrijtjet në rrafshet urbanistiko-arkitekturore:

a) Ansambli në lagjen nr.3 është pjesa më e vjetër e ruajtur e qytetit, *varoshit*, si pjellë e kalasë mesjetare të shekullit XII-XIV, e cila ruan rrjetin rrugor karakteristik dhe një fond ndërtimesh të vjetra, që krijojnë, ndonëse jo në mënyrë të plotë, atmosferën e jetës së një periudhe të hershme të zhvillimit të qytetit.

b) Ansambli i pazarit të vjetër, i rindërtuar nga mesi i shek.XIX e në vazhdim, dëshmon për karakterin ekonomik e shoqëror të qytetit. Ai ruan të gjithë komponentët përbërës të pazareve mesjetare: sheshet e tregtimit, dyqanet-punishtet, hanet, si dhe një numër ndërtesash me vlera arkitektonike e konstruktive.

c) Ansambli në lagjen nr.12 dokumenton fillimet dhe ecurinë në kohë të sistemit urbanistik ortogonal të bazuar në këtë lagje gjatë zgjerimit të qytetit në troje të reja, duke filluar nga gjysma e dytë e shek.XIX.

d) Ansamblet në të dyja anët e bulevardit “Republika” dokumentojnë përmirësimet e sistemit urbanistik të qytetit dhe konceptimet e reja funksionale të njësive ndërtimore gjatë periudhës më të re të zhvillimit të qytetit, rreth fillimit të shek.XX.

Neni 4

Ansambli urban (zona e mbrojtur)

Zona e mbrojtur shtrihet përreth qendrës historike. Ajo ruan vlera historiko-kulturore, me të cilat plotëson dhe pasuron vlerat e qendrës historike dhe krijon një kalim të butë prej saj drejt pjesëve të reja të qytetit.

Në zonën e mbrojtur, krahas ruajtjes dhe restaurimit të monumenteve të kategorisë së parë dhe të dytë, që ndodhen në të, ruhen dhe restaurohet rrjeti urbanistik, si dhe mjedisi tradicional, i kultivuar ose i pakultivuar. Në këtë zonë ka edhe ndërtime që nuk janë monumente kulture, por që mund të trajtohen duke respektuar këtë rregullore dhe legjislacionin në fuqi.

Neni 5

Zonat me potencial arkeologjik

Zonat me potencial arkeologjik ndodhen në ish-lagjen “Kala”, prapa hotel “Gramozit”, ku herë pas here janë zbuluar gjurmë të kalasë së vjetër të Korçës, si dhe në zonën pas bankës. Për ndërtimet ose punimet e ndryshme në këtë zonë dhe kur zbulohen gjurmë me vlera arkeologjike, veprohet sipas ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, nenit 30, pikës 4.

Neni 6

Ndarja e monumenteve sipas kategorisë

Monumentet e kulturës në qytetin e Korçës, sipas vlerave të tyre historiko-kulturore ndahen në dy kategori: monumente të kategorisë së parë dhe monumente të kategorisë së dytë. Ato ndodhen në qendrën historike, në zonën e mbrojtur, ose në pjesët e tjera të qytetit. Kjo ndarje sipas vlerave, pasqyrohet në shkallën e ruajtjes së tyre, si dhe në mënyrat dhe shkallën e ndërhyrjes konservuese dhe restauruese.

Monumentet e kategorisë së parë janë shembujt me vlera të rëndësishme tipologjike dhe arkitekturore, që pasqyrojnë zhvillimin tipologjik dhe karakteristikat arkitektoniko-teknike të banesës tradicionale korçare.

Monumentet e kategorisë së dytë janë ndërtime me vlera historiko-kulturore, kryesisht si formuese të ansambleve urbanistiko-arkitekturore, marrin pjesë në formulimin kompozicional të qytetit, por dhe ruajnë vlera arkitekturore në vetvete.

Neni 7

Ndërhyrjet në qendrën historike

1. Ndërhyrjet konservuese dhe restauruese në qendrën historike, si dhe në monumentet e të dyja kategorive mbështeten në kriteret për konservimin dhe restaurimin, të saktësuara në aktet normative kombëtare dhe ndërkombëtare të fushës, të zbatueshme edhe në vendin tonë.

2. Në qendrën historike ndërhyrjet restauruese synojnë ruajtjen e hapësirave urbanistiko-arkitekturore, rrjetit rrugor tradicional në kompozim dhe teknikë, si dhe të hapësirave pushuese dhe të gjelbërimit tradicional.

3. Për qendrën historike kryhen studime për rehabilitimin e zonave të veçanta të saj, lidhur me qëndrimin karshi ndërtimeve, që me volume dhe formulimin e tyre arkitekturor dëmtojnë vlerat dhe njësinë kompozicionale të këtyre zonave.

4. Këto studime përcaktojnë objektet, ku kryhen punime konservuese dhe restauruese, objektet ku kryhen ritrajtime për të rritur vlerat e tyre, objektet në gjendje rrënoje ose të papërshtatshme për funksionim dhe që cenojnë unitetin arkitekturor të ansamblit ose zonës, ku lejohet të kryhen rikonstruksione, zonat ku lejohet të kryhen ndërhyrje integruese, si dhe parcelat e gjelbëruara.

5. Ritrajtimet dhe rikonstruksionet duhet të integrohen në tërësinë arkitekturore të ansamblit

apo të zonës, duke respektuar kompozimet dhe trajtimet e pamjeve të jashtme të ndërtimeve të vëna në mbrojtje dhe duke mos tejkaluar lartësinë maksimale të tyre.

Neni 8

Ndërhyrjet në monumente

Ndërhyrjet në monumentet e kategorisë së parë ruajnë mbarë kompozimin dhe teknikat origjinale si në brendësi, ashtu edhe në pamjet e jashtme. Oborri, muret rrethuese, porta e jashtme dhe ndërtimet ndihmëse, janë pjesë organike e monumentit dhe, si të tilla, i nënshtrohen të njëjtit trajtim. Në rastet kur një pjesë e monumentit ka pësuar dëmtime, transformime ose mungon, mund të ndërmerren ndërhyrje plotësuese sipas gjendjes fillestare.

Ndërhyrjet në monumentet e kategorisë së dytë ruajnë volumin fillestar dhe formulimin e pamjes së jashtme, ndërsa në brendësi mund të bëhen ndryshime, duke zbatuar kompozime sipas kërkesave të kohës dhe teknikat e sotme.

Neni 9

Projektimi dhe zbatimi i punimeve

Studimi, projektimi dhe zbatimi i punimeve konservuese dhe restauruese, në qendrën historike dhe në monumentet e të dyja kategorive, kryhen nga institucionet shtetërore të specializuara, si dhe nga subjekte të licencuara për restaurimin e monumenteve, sipas kuadrit ligjor në fuqi dhe miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit.

Neni 10

Ndërhyrjet në ansamblin urban (zona e mbrojtur)

Në zonën e mbrojtur ruhet rrjeti rrugor në kompozimin dhe formulimin e tij urbanistiko-arkitektonik. Në këtë zonë kryhen restaurime, përshtatje, rikonstruksione apo dhe ndërtime të reja për të rritur vlerat e kësaj zone dhe përmirësimin e kushteve të jetesës, të cilat duhet të jenë në harmoni me karakterin arkitektonik e urbanistik të ansamblit:

1. Nuk lejohen ndryshimet në rrjetin rrugor ekzistues.
2. Lartësia maksimale e ndërtimeve të reja apo rikonstruksioneve dhe përshtatjeve nuk duhet t'i kalojë 3 katet.
3. Kompozimi arkitektonik i ndërtesave duhet t'i përshtatet karakterit arkitektonik e dekorativ të arkitekturës tradicionale, duke përdorur stilizime të elementeve morfologjike të saj, të kompozimeve vëllimore, ngjyrave etj.
4. Specifikimet e detajuara teknike për përshtatjet, rikonstruksionet apo dhe ndërtimet e reja përcaktohen nga Instituti i Monumenteve të Kulturës në bashkëpunim me Drejtorinë Rajonale të Kulturës Kombëtare Korçë dhe me zyrat përkatëse të organeve të qeverisjes vendore.
5. Projektet për përshtatjet, rikonstruksionet apo dhe ndërtimet e reja miratohen nga Këshilli Kombëtar i Restaurimit dhe, më pas, nga organizmat përkatës të qeverisjes vendore.

Neni 11

Shfrytëzimi i monumenteve

Monumentet e kulturës janë pjesë e jetës bashkëkohore. Ato shfrytëzohen, sipas rastit, për funksionet për të cilat janë ndërtuar, apo dhe për funksione të tjera, me kusht që këto funksione të mos cenojnë vlerat për të cilat monumenti është vënë në mbrojtje. Mënyrat e përdorimit përcaktohen në ligjin nr.9048, datë 7.4.2003 "Për trashëgiminë kulturore", të ndryshuar.

Neni 12

Mbrojtja e monumenteve

Organet e qeverisjes vendore, në bashkëpunim me institucionet shtetërore të specializuara, sigurojnë ruajtjen dhe mbrojtjen e monumenteve të ngritura në hapësirat e juridiksionit të tyre.

Plani rregullues i qytetit të Korçës, detyrimisht merr parasysh vlerat e qendrës historike dhe të ansamblit urbanistik rreth saj (zonës së mbrojtur dhe zonave me potencial arkeologjik).

Neni 13

Komiteti Mbikëqyrës i Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur

Për të ndihmuar dhe mbikëqyrur veprimtarinë dhe vlerësimin e qendrës historike, zonës së mbrojtur, zonave me potencial arkeologjik dhe monumenteve të kulturës në qytetin e Korçës, pranë bashkisë së qytetit ngrihet Komiteti Mbikëqyrës i Qendrës Historike dhe Zonës së Mbrojtur. Ky komitet është një strukturë këshillimore dhe jo vendimmarrëse, i cili përbëhet nga 9 anëtarë. Kryetari i këtij komiteti caktohet nga kryetari i njësisë së qeverisjes vendore të qytetit të Korçës dhe ka në përbërjen e tij përfaqësues të institucioneve shtetërore, të shoqatës së arkitektëve të qytetit, të përfaqësuesve të banorëve të Qendrës Historike dhe të zonës së mbrojtur dhe organizmave joshtetërore, që ushtrojnë veprimtari për mbrojtjen e vlerave historiko-kulturore të qytetit të Korçës. Mënyra e organizimit dhe funksionimit të këtij komiteti përcaktohet në rregulloren e funksionimit të brendshëm që miratohet me 50% + 1 të votave të të gjithë anëtarëve.

Neni 14

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Për të gjitha çështjet që nuk trajtohen dhe për pasojë nuk zgjidhen në këtë rregullore, sipas kompetencave, ato zgjidhen prej Institutit të Monumenteve të Kulturës dhe Ministrisë së Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

Neni 15

Kundërvajtjet administrative

Shkelja e kësaj rregulloreje ngarkon me përgjegjësi sipas dispozitave të ligjit nr.9048, datë 7.4.2003 “Për trashëgiminë kulturore”, të ndryshuar, dhe Kodit Penal të Republikës së Shqipërisë.

Neni 16

Dispozita të fundit

Shtesat dhe ndryshimet në këtë rregullore bëhen me propozim të Ministrit të Kulturës, Rinisë dhe Sporteve dhe miratohen nga Këshilli i Ministrave. Kjo rregullore shoqërohet me hartën përkatëse të qendrës historike dhe ansamblit urban të qytetit të Korçës.

Brenda 6 muajve nga botimi në Fletoren Zyrtare të kësaj rregulloreje, Instituti i Monumenteve të Kulturës i paraqet ministrit përgjegjës për trashëgiminë listën e monumenteve të kulturës së kategorisë I dhe II për shqyrtim dhe miratim.

VENDIM
Nr.262, datë 6.4.2011

**PËR NJË SHITESË FONDI NË BUXHETIN E VITIT 2011, MIRATUAR PËR MINISTRINË
E SHËNDETËSISË, PËR MBULIMIN E SHPENZIMEVE TË KURIMIT TË Z.ROLAND
TREBICKA, NË FRANCË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 5 e 45 të ligjit nr.9936, datë 26.6.2008 “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë” dhe të nenit 13 të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Shëndetësisë, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Ministrisë së Shëndetësisë, në buxhetin e miratuar për vitin 2011, në zërin “Mallra dhe shërbime”, t’i shtohet fondi prej 4 700 000 (katër milionë e shtatëqind mijë) lekësh, për përballimin e shpenzimeve të kurimit të zotit Roland Trebicka, në Francë.
2. Ky fond të përballohet nga fondi rezervë i Buxhetit të Shtetit.
3. PAGESA të bëhet me paraqitjen e faturave origjinale të institucionit të kurimit.
4. Ngarkohen Ministria e Shëndetësisë dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.263, datë 6.4.2011

**PËR DISA SHITESA NË VENDIMIN NR.759, DATË 15.9.2010 TË KËSHILLIT TË
MINISTRAVE “PËR KUOTAT FINANCIARE TË USHQIMIT NË MENSA E KONVIKTE,
BURSAT E SHTETIT DHE PAGESAT E NXËNËSVE DHE TË STUDENTËVE NË
INSTITUCIONET ARSIMORE PUBLIKE, PËR VITIN SHKOLLOR 2010-2011”, TË
NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të neneve 1 dhe 5 të ligjit nr.10 289, datë 17.6.2010 “Për mënyrën e trajtimit ekonomik e financiar dhe për dhënie ndihme të menjëhershme familjeve të punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit, të Forcave të Armatosura, të Shërbimit Informativ Shtetëror dhe të Policisë së Burgjeve, që humbin jetën në krye apo për shkak të detyrës”, të nenit 63 të ligjit nr.7952, datë 21.6.1995 “Për sistemin arsimor parauniversitar”, të ndryshuar, të nenit 29 të ligjit nr.8872, datë 29.3.2002 “Për arsimim dhe formim profesional në Republikën e Shqipërisë”, të nenit 57 të ligjit nr.9741, datë 21.5.2007 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, të ligjit nr.7889, datë 14.12.1994 “Për statusin e invalidit”, të ndryshuar, të ligjit nr.8153, datë 31.10.1996 “Për statusin e jetimit”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr.10 355, datë 2.12.2010 “Për buxhetin e vitit 2011”, me propozimin e Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Pas pikës 14 të vendimit nr.759, datë 15.9.2010 të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, të shtohet pika 14.1, me këtë përmbajtje:

“14.1. Afati përfundimtar për shqyrtimin dhe miratimin e bursave për vitet e para për bashkinë e Tiranës dhe bashkinë e Kuçovës, është data 15 prill 2011.”.

2. Ngarkohen Ministria e Arsimit dhe Shkencës, DAR/ZA-të, institucionet e arsimit të lartë dhe njësitë e pushtetit vendor për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë, botohet në Fletoren Zyrtare dhe i shtrin efektet financiare nga data 1 shtator 2010.

KRYEMINISTRI
Sali Berisha

VENDIM
Nr.87, datë 28.3.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“TV ARV”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Kodit të Procedurave Administrative, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat vendor “TV ARV”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet që nga data 9.11.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.88, datë 28.3.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“TV 4+”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat vendor “TV 4+”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.

2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.

Ky vendim i shtrin efektet që nga data 8.11.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

2261

VENDIM
Nr.89, datë 28.3.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“TV MATI”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor “TV Mati”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet që nga data 8.11.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.90, datë 28.3.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“TV KRUA”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat vendor “TV Kruja”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet që nga data 3.1.2011 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.91, datë 28.3.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“TV BERATI”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat vendor “TV Berati”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet që nga data 8.7.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.92, datë 28.3.2011

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT VENDOR
“CLUB TV”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së, “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit,

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat vendor “Club TV”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet që nga data 8.11.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.93, datë 28.3.2011

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR ANI”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së, “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat kabllor “TV kabllor ANI”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore kabllore.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet që nga data 12.11.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.94, datë 28.3.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR EGNATIA”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat kabllor “TV kabllor Egnatia”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore kabllore.
 2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
- Ky vendim i shtrin efektet që nga data 21.10.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.95, datë 28.3.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR ELBASAT”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv vendor kabllor “TV kabllor Elbasat”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore kabllore.
 2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
- Ky vendim i shtrin efektet që nga data 8.4.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.96, datë 28.3.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR BULQIZA”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat kabllor “TV kabllor Bulqiza”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore kabllore.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet që nga data 28.12.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.97, datë 28.3.2011

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR KUKËSI”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat kabllor “TV kabllor Kukësi”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore kabllore.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet që nga data 28.12.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.98, datë 28.3.2011

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR KUÇOVA”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat kabllor “TV kabllor Kuçova”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore kabllore.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet që nga data 12.11.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.99, datë 28.3.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR MATI”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat kabllor “TV kabllor Mati”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore kabllore.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet që nga data 12.11.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.100, datë 28.3.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR HB-CA”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.01.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat kabllor “TV kabllor HB-CA”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore kabllore.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet që nga data 10.9.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.101, datë 28.3.2011

PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR ASPARAG”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat kabllor “TV kabllor Asparag”, në fushën e transmetimeve televizive tokësore kabllore.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet që nga data 28.12.2010 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.102, datë 28.3.2011

**PËR RINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO MAGIC STAR”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit

VENDOSI:

1. Të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Magic Star”, në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore analoge.
2. Kushtet e licencës sipas pikës 1 të këtij vendimi mbeten të pandryshuara.
Ky vendim i shtrin efektet që nga data 9.11.2009 dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.103, datë 28.3.2011

**MBI MOSRINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO LEZHA”**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Sami Neza	anëtar
Gent Ibrahim	anëtar (në mungesë)
Zylyftar Bregu	anëtar

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës për rinovim licence të paraqitur nga subjekti radiofonik privat vendor “Radio Lezha”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 22, 25 dhe 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullorja “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, vendimi i KKRT-së nr.215, datë 20.12.2010 “Për

shqyrtimin e dokumentacionit të paraqitur për rinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Lezha”, ligji nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

VËREN SE:

KKRT-ja, me vendimin nr.296, datë 22.12.2004, ka licencuar subjektin, personin fizik z. Gjovalin Dushaj, për radion private vendore “Radio Lezha”. Me vendimin nr.701, datë 16.7.2008, KKRT-ja ka rinovuar licencën e këtij subjekti për një periudhë 3-vjeçare. Në përfundim të afatit të vlefshmërisë së licencës, subjekti radiofonik privat vendor ka depozituar në KKRT aplikimin përkatës për rinovimin e licencës.

Në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit tërësor të aplikimit nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, KKRT-ja me vendimin nr.215, datë 20.12.2010, vendosi paraprakisht mosrinovimin e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Lezha”, për arsyet e parashtruara në vendim.

Sipas pikës dy të vendimit, ky subjekt kishte të drejtë që brenda 30 ditëve të parashtronte pretendimet e tij lidhur me këtë vendim.

Me shkresën e datës 31.1.2011, subjekti radiofonik privat vendor “Radio Lezha”, përfaqësuar nga znj. Olta Paja, ka depozituar në KKRT, plotësimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës.

Nga shqyrtimi dhe verifikimi i dokumentacionit të paraqitur rezulton se është paraqitur një deklaratë mbi arsyen e shitjes së aktivitetit, deklaratat e pesë anëtarëve të bordit drejtues, fotokopje e kontratës së shitjes së radios “Lezha”, pasqyrat financiare të subjektit për vitin 2009, projekti teknik i firmosur në fletën e parë nga ing. Gjin Marku, fotokopje e NIPT-it dhe mandatpagesa për shlyerjen e detyrimeve financiare ndaj KKRT-së.

Konkretisht, subjekti person fizik z.Gjovalin Dushaj, i licencuar nga KKRT-ja për radion “Lezha”, ka deklaruar arsyet e shitjes së aktivitetit, ndër të cilat theksohet pamundësia financiare për ta vazhduar më tej aktivitetin e kësaj radioje. Subjekti deklaron se ka bërë ndryshimet e kërkuara nga ligji në organet tatimore.

Subjekti radiofonik privat vendor “Radio Lezha”, nuk ka respektuar nenin 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar, sipas të cilit subjektet janë të detyruara të njoftojnë KKRT-në për çdo ndryshim të të dhënave që kanë paraqitur në kërkesën për marrje licence, jo me vonë se 15 ditë pas bërjes së këtyre ndryshimeve. Subjekti në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka tjetërsuar licencën e radios private vendore “Lezha”, dhe për këtë ndryshim nuk ka kërkuar miratimin e KKRT-së.

Gjithashtu, subjekti nuk ka depozituar kontratat individuale të punës, kapitali financiar rezulton me vlerë 186.861 lekë, vlerë, e cila nuk është në përputhje me kriterin e parashikuar në rregulloren “Kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr.355, pika 2, datë 29.8.2005 të KKRT-së.

Nga sa më sipër, rezulton se nuk mund të rinovohet licenca për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Lezha”.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 22, 25 dhe nenit 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, vendimit nr.215, datë 20.12.2010 të KKRT-së dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të mos rinovojë licencën me nr. 060/FML, të subjektit radiofonik privat vendor “Radio Lezha”.
 2. Licenca nr.060/FML bëhet e pavlefshme.
 3. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM

Nr.104, datë 28.3.2011

MBI MOSRINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR PËRMETI”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Sami Neza	anëtar
Gent Ibrahim	anëtar (në mungesë)
Zylyftar Bregu	anëtar

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës për rinovim licence të paraqitur nga subjekti televiziv privat kabllor “TV kabllor Përmeti”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 22, 25 dhe 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullorja “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, vendimi nr.140, datë 22.10.2010 i KKRT-së “Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “TV kabllor Përmeti”, ligji nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

VËREN SE:

KKRT-ja, me vendimin nr.282, datë 29.10.2004, ka licencuar subjektin, personin fizik z. Hajri Olldashi, për operatorin televiziv privat kabllor “TV kabllor Përmeti”. Në përfundim të afatit të licencës, subjekti televiziv privat kabllor “TV kabllor Përmeti” ka paraqitur dokumentacionin për rinovimin e licencës.

Në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit tërësor të aplikimit nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, KKRT-ja me vendimin nr.140, datë 22.10.2010 të KKRT-së ka vendosur mosrinovimin paraprak të licencës së subjektit televiziv privat kabllor “TV kabllor Përmeti”, për shkaqet e parashtruara në vendim.

Sipas pikës dy të vendimit, ky subjekt kishte të drejtë që brenda 30 ditëve të parashtronte pretendimet e tij lidhur me këtë vendim.

Në datën 18.11.2010, subjekti televiziv privat kabllor “TV kabllor Përmeti”, ka depozituar me shkresën nr.1483/1 prot., dokumentacionin plotësues për rinovimin e licencës. Konkretisht subjekti ka depozituar ekstraktin e QKR-së të datës 15.7.2010, nga i cili rezulton se shoqëria “Envo

Company” sh.p.k., është regjistruar si e tillë në datën 10.2.2009. Objekti i veprimtarisë së shoqërisë është: “Veprimtari radiotelevizive dhe çdo veprimtari tjetër në fushën e komunikimit radioteleviziv dhe internet”. Selia e shoqërisë është në Berat, lagjja “Çlirim”, pranë Ofiçinës së Parkut dhe ortakë janë: Valbona Olldashi me 51% të kuotave të pjesëmarrjes dhe Ilir Olldashi me 49% të kuotave të pjesëmarrjes, ndërsa përfaqësuesi ligjor i shoqërisë është Ilir Olldashi.

Subjekti ka dorëzuar deklaratën personale të z.Illir (Hajri) Olldashi të vërtetuar para noterit, për vërtetësinë e të dhënave të paraqitura. Gjithashtu, subjekti ka dorëzuar dokumentacionin lidhur me programacionin, ka depozituar projektin teknik, ka depozituar listën emërore të 5 anëtarëve të bordit drejtues, CV e tyre në të cilat mungon pasqyrimi i eksperiencave të mëparshme në punë, deklaratat personale, kontratat e punës, si dhe vërtetimin e kontributeve të sigurimeve shoqërore vetëm për vitin 2009.

KKRT-ja vëren se subjekti nuk ka paraqitur vërtetimin e sigurimeve shoqërore për vitet e tjera të periudhës së licencimit. Gjithashtu, rezulton se subjekti ka depozituar të dhënat mbi kapitalin financiar, parashikimin e planit ekonomik, bilancin financiar për vitin 2008, por rezulton se subjekti nuk ka shlyer sanksionet me gjobë, duke mbetur debitor ndaj KKRT-së.

Subjekti televiziv privat kabllor “TV kabllor Përmeti”, nuk ka respektuar nenin 30 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar, sipas të cilit subjektet janë të detyruar të njoftojnë KKRT-në për çdo ndryshim të të dhënave që kanë paraqitur në kërkesën për marrje licence, jo më vonë se 15 ditë pas bërjes së këtyre ndryshimeve. Subjekti në kundërshtim me nenin 22 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, ka tjetërsuar licencën e subjektit televiziv dhe për këtë ndryshim nuk ka kërkuar miratimin e KKRT-së.

Nga sa më sipër, rezulton se nuk mund të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat kabllor “TV kabllor Përmeti”.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7 pika 21, nenit 22, 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotelevizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, vendimit nr.140, datë 22.10.2010 i KKRT-së dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të mos rinovojë licencën me nr.025/RTV kabllor, të subjektit televiziv privat kabllor “TV kabllor Përmeti”.
 2. Licenca nr.025/RTV kabllor bëhet e pavlefshme.
 3. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.105, datë 28.3.2011

MBI MOSRINOVIMIN E LICENCËS SË SUBJEKTIT TELEVIZIV PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR AL-TE”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Sami Neza	anëtar
Gent Ibrahim	anëtar (në mungesë)
Zylyftar Bregu	anëtar

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës për rinovim licence të paraqitur nga subjekti televiziv privat kabllor “TV kabllor AL-TE”.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21, neni 25 i ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullorja “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, vendimi nr.157, datë 22.10.2010 i KKRT-së “Mbi shqyrtimin e dokumentacionit për rinovimin e licencës së subjektit televiziv privat kabllor “TV kabllor AL-TE”, ligji nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

VËREN SE:

KKRT-ja, me vendimin nr.277, datë 29.10.2004, ka licencuar subjektin, shoqërinë “AL-TE kabllor” sh.p.k., si operator televiziv privat kabllor “TV kabllor AL-TE”. Në përfundim të afatit të licencës, subjekti televiziv privat kabllor “TV kabllor AL-TE” ka paraqitur dokumentacionin për rinovimin e licencës.

Në përfundim të shqyrtimit dhe vlerësimit tërësor të aplikimit nga ana e Komisionit të Shqyrtimit të Dokumentacionit, KKRT-ja me vendimin nr.157, datë 22.10.2010 ka vendosur mosrinovimin paraprak të licencës së subjektit televiziv privat kabllor “TV kabllor AL-TE” për shkaqet e parashtruara në vendim.

Sipas pikës dy të vendimit, ky subjekt kishte të drejtë që brenda 30 ditëve të parashtronte pretendimet e tij lidhur me këtë vendim. Subjekti nuk ka paraqitur pretendime me shkrim për vendimin e mësipërm.

KKRT-ja konstaton se subjekti televiziv privat kabllor “TV kabllor AL-TE” nuk ka shlyer detyrimet financiare ndaj KKRT-së dhe nuk ka depozituar asnjë bilanc vjetor me përjashtim të bilancit ekonomiko-financiar të vitit 2009. Depozitimi i bilanceve është detyrim ligjor i parashikuar në nenin 48 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë” të ndryshuar.

Nga sa më sipër, rezulton se nuk mund të rinovohet licenca për subjektin televiziv privat kabllor “TV kabllor AL-TE”.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21, nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi procedurat e rilicencimit të operatorëve privatë radiotevizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010 të KKRT-së, vendimit nr.157, datë 22.10.2010 të KKRT-së dhe ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Të mos rinovojë licencën me nr.020/RTV kabllor të subjektit televiziv privat kabllor “TV kabllor AL-TE”.
 2. Licenca nr.020/RTV kabllor bëhet e pavlefshme.
 3. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë, në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.109, datë 28.3.2011

**PËR DHËNIE LICENCE PERSONIT FIZIK Z. SHABAN MERKAJ, PËR TELEVISIONIN
PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR LAPARDHA”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e personit fizik z.Shaban Merkaaj, për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. T’i japë licencë, personit fizik z. Shaban Merkaaj, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV Lapardha”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal komunën Otlak.
 2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.110, datë 28.3.2011

**PËR DHËNIE LICENCE PERSONIT FIZIK Z. VULLNET NAZËRAJ, PËR
TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR ARD&NET”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e personit fizik z.Vullnet Nazëraj, për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. T'i japë licencë, personit fizik z.Vullnet Nazëraj, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për "TV ARD&NET", për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal komunën Frakull.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM

Nr.111, datë 28.3.2011

**PËR DHËNIE LICENCE PERSONIT FIZIK Z. GJERGJ GEGA, PËR TELEVISIONIN
PRIVAT KABLLOR "TV KABLLOR MAMURRAS"**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabllor", miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e personit fizik z.Gjergj Gega, për t'u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. T'i japë licencë, personit fizik z.Gjergj Gega, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për "TV Mamurras", për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal qytetin e Mamurrasit.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM

Nr.112, datë 28.3.2011

**PËR DHËNIE LICENCE PERSONIT FIZIK ZNJ.ËNGJËLLUSHE VELIAJ, PËR
TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR "TV KABLLOR OREXH"**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabllor", miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e personit fizik znj.Engjëllushe Veliaj, për t'u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. T'i japë licencë, personit fizik znj.Engjëllushe Veliaj, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për "TV Orexh", për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal komunën Mbrostar dhe fshatin Patos.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM

Nr.113, datë 28.3.2011

**PËR DHËNIE LICENCE PERSONIT FIZIK Z.BILBIL HAJDINI, PËR TELEVISIONIN
PRIVAT KABLLOR "TV KABLLOR ALFA HAJDINI"**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 "Për radion dhe televisionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo", miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së "Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë", miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e personit fizik z.Bilbil Hajdini, për t'u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. T'i japë licencë, personit fizik z. Bilbil Hajdini, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për "TV Alfa Hajdini", për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal fshatin "Afrim i Ri", në komunën Qendër, Fier.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.114, datë 28.3.2011

PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT PËR TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR
“TV KABLLOR XHAÇI”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën televizionit privat kabllor “TV Xhaçi” për zgjerimin e zonës së licencimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit televiziv privat kabllor “TV Xhaçi”, sipas licencës nr. 086RTVKABLLOR, në qytetin e Bilishtit.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.115, datë 28.3.2011

PËR DHËNIE LICENCE PERSONIT FIZIK Z.GËZIM CAKE, PËR TELEVISIONIN
PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR ZARGOÇAN”

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e personit fizik z.Gëzim Cake, për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. T’i japë licencë, personit fizik z. Gëzim Cake, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV Zargoçan”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence për të mbuluar me sinjal fshatin Zargoçan.
2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

2275

VENDIM
Nr.116, datë 28.3.2011

**PËR DHËNIE LICENCE PERSONIT FIZIK Z. ARBEN ASLLANI, PËR TELEVISIONIN
PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR 2ASL”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e personit fizik z. Arben Asllani, për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. T’i japë licencë, personit fizik z. Arben Asllani, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV 2ASL”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence për të mbuluar me sinjal komunat Shirgjan dhe Funar.
 2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.117, datë 28.3.2011

**PËR DHËNIE LICENCE PERSONIT FIZIK Z.FREDI HASA, PËR
TELEVISIONIN PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR PIRG”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e personit fizik z.Fredi Hasa, për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. T’i japë licencë, personit fizik z.Fredi Hasa, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV Pirg”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal komunën Pirg.
 2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.118, datë 28.3.2011

**PËR DHËNIE LICENCE PERSONIT FIZIK Z.ADEM BORIÇI, PËR TELEVISIONIN
PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR BRADO”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e personit fizik z.Adem Boriçi, për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. T’i japë licencë, personit fizik z. Adem Boriçi, duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV Brado”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal komunën Bradashesh.
 2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.119, datë 28.3.2011

**PËR DHËNIE LICENCE SHOQËRISË “MASA GRUP 2009” SHPK PËR TELEVISIONIN
PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR MASA GRUP”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kabull”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e shoqërisë “Masa Grup 2009” sh.p.k., për t’u licencuar si operator televiziv privat kabllor,

VENDOSI:

1. T’i japë licencë shoqërisë “Masa Grup 2009” sh.p.k., duke e autorizuar të funksionojë si operator televiziv privat kabllor për “TV Masa Grup”, për një periudhë prej 6 vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal komunat Vreshtas dhe Pirg.
 2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.
- Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.120, datë 28.3.2011

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE “ABC NEWS”
SUBJEKTIT: SHOQËRIA “ABC NEWS” SHA

Në mbështetje të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit “ABC News” sh.a. për t’u licencuar si operator radiofonik privat vendor;

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit, shoqërisë “ABC News” sh.a. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethet Tiranë - Durrës, qytetin e Fierit dhe qarkun e Vlorës.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.121, datë 28.3.2011

PËR DHËNIE LICENCE PËR RADION PRIVATE VENDORE “RADIO EPIRI 2011”
SUBJEKTIT: SHOQËRISË “RADIO EPIRI” SHPK

Në mbështetje të ligjit nr. 8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik dhe privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Mbi kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, rregullores “Për licencimin e operatorëve privatë për transmetim radioteleviziv analogjik tokësor në nivel vendor”, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e subjektit “Radio Epiri” për t’u licencuar si operator radiofonik privat vendor,

VENDOSI:

1. T’i japë subjektit shoqërisë “Radio Epiri” sh.p.k. licencë, duke e autorizuar të funksionojë si operator radiofonik vendor privat, në fushën e transmetimeve tokësore analogjike për një periudhë prej 3 (tre) vjetësh nga data e hyrjes në fuqi të kësaj licence, për të mbuluar me sinjal rrethin Gjirokastrë.

2. Në aneksin e licencës jepen kushtet e licencës, ku përfshihen struktura programore, zona e mbulimit, kushtet teknike dhe tarifat.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.122, datë 28.3.2011

**PËR ZGJERIMIN E ZONËS SË LICENCIMIT, SHOQËRISË “MRM” SHPK, PËR
TELEVIZIONIN PRIVAT KABLLOR “TV KABLLOR KORÇA”**

Në mbështetje të nenit 7 pika 21 dhe nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Për licencimin e operatorëve privatë radiotelevizivë të transmetimeve me kablo”, miratuar me vendimin nr.221, datë 30.3.2004, të ndryshuar, rregullores së KKRT-së “Mbi procedurat e licencimit dhe rilicencimit të operatorëve privatë radio e televizivë”, miratuar me vendimin nr.1, datë 29.1.2010, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, pasi mori në shqyrtim kërkesën e televizionit privat kabllor “TV Korça” për zgjerimin e zonës së licencimit,

VENDOSI:

1. Të miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit televiziv privat kabllor “TV Korça”, sipas licencës nr. 019RTVKABLLOR, në komunat Drenovë, Libonik, Bulgarec dhe Mollaj.
2. Karakteristikat teknike janë pjesë e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjitha kushteve të saj.
3. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve përkatëse në licencën e subjektit.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.123, datë 28.3.2011

**MBI SHQYRTIMIN E KËRKESËS SË PARAQITUR NGA SHOQËRIA
“FOKUS CABLE” SHPK**

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Sami Neza	anëtar
Gent Ibrahim	anëtar (në mungesë)
Zylyftar Bregu	anëtar

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Për shqyrtimin e kërkesës së paraqitur nga shoqëria “Fokus Cable” sh.p.k., për rishikimin e vendimit nr.4, datë 21.1.2011 të KKRT-së.

BAZA LIGJORE: Neni 7 pika 21 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullorja “Kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr.355, pika 2, datë 29.8.2005 të KKRT-së, neneve 121, 124 e 135 i ligjit nr. 8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”.

VËREN SE:

KKRT-ja, me vendimin nr.4, datë 21.1.2011, ka vendosur të mos miratojë zgjerimin e zonës së licencimit të subjektit televiziv privat kabllor “TV kabllor Fokus” për komunën Pirg, pasi nga shqyrtimi i dokumentacionit rezultoi se të dhënat mbi kapitalin financiar ishin paraqitur me anë të listës së pajisjeve të transmetimit në masën 10.790.000 lekë (ndërkohë që vlera e kapitalit financiar është kërkuar në vlerën jo më pak se 20 milionë lekë) dhe subjekti nuk kishte paraqitur garancinë bankare në masën 10% të kapitalit shtesë.

Me shkresën nr.339 prot., datë 23.2.2011, subjekti është ankuar ndaj këtij vendimi duke kërkuar rishikimin e tij dhe miratimin e zgjerimit të zonës së licencimit të subjektit televiziv privat kabllor “TV kabllor Fokus”.

Nga shqyrtimi i aplikimit të subjektit “Fokus Cable” sh.p.k., rezulton se kapitali themeltar është paraqitur në vlerën 10.790.000 lekë. Në rregulloren “Kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr.355, pika 2, datë 29.8.2005 të KKRT-së, në pikën 7 janë parashikuar kushtet financiare për dhënien e licencës, dhe rezulton se “2. Për transmetimet radio apo televizive me kablo, licenca u jepet vetëm subjekteve që kanë kapital të vërtetuar në masën jo më pak se 10 milionë lekë.”, kusht, i cili është përmbushur nga ana e subjektit aplikues për zgjerim zone.

Sa më sipër, KKRT-ja e gjen kërkesën e shoqërisë “Fokus Cable” sh.p.k., të drejtë e të mbështetur në ligj,

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, rregullores “Kriteret për dhënien e licencave për transmetime televizive dhe radio FM analoge tokësore në nivel vendor”, miratuar me vendimin nr.355, pika 2, datë 29.8.2005 të KKRT-së, neneve 121, 124 dhe 135 të ligjit nr.8485, datë 12.5.1999 “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Pranimin e kërkesës.
2. Revokimin e vendimit nr.4, datë 21.1.2011 “Për moszgjerimin e zonës së licencimit shoqërisë “Fokus Cable” sh.p.k., për televizionin privat kabllor “TV kabllor Fokus”.
3. Zgjerimin e zonës së licencimit shoqërisë “Fokus Cable” sh.p.k., për subjektin televiziv privat kabllor “TV kabllor Fokus”, në komunën Pirg.
4. Karakteristikat teknike janë pjesë përbërëse e licencës përkatëse dhe u nënshtrohen të gjithë kushteve të saj.
5. Ngarkohet administrata e KKRT-së për pasqyrimin e ndryshimeve në licencën e subjektit. Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM
Nr.138, datë 28.3.2011

MBI PAVLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR
“RADIO ARMONIA”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Sami Neza	anëtar
Gent Ibrahim	anëtar (në mungesë)
Zylyftar Bregu	anëtar

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi pavlefshmërinë e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Armonia”.

BAZA LIGJORE: Neni 7, pika 21, neni 25 dhe neni 33, pika 1 e ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr.738, datë 29.9.2008 “Mbi pavlefshmërinë e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Armonia”.

VËREN SE:

KKRT-ja me vendimin nr.345, datë 20.5.2005, ka licencuar shoqërinë “Dropulli” sh.p.k., si operator vendor radio FM private në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh, për të mbuluar me sinjal rrethin Gjirokastër. Në mbështetje të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar: “Kërkesa për rinovimin e licencës bëhet 90 ditë përpara përfundimit të saj, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit vendos për rinovimin ose për shpalljen e konkurrimit të kandidaturave të reja nëse i licencuari nuk ka qenë i rregullt në zbatimin e këtij ligji”.

Me shkresën nr.170 prot., datë 18.2.2008, KKRT-ja ka njoftuar subjektin radiofonik privat “Radio Armonia” se nëse dëshiron të vazhdojë veprimtarinë për të cilën është licencuar, duhet të paraqesë kërkesën së bashku me dokumentacionin për rinovimin e licencës deri në datën 23.2.2008.

Në mungesë të shfaqjes së interesit, KKRT-ja me vendimin nr.738, datë 29.9.2008, ka vendosur të bëjë paraprakisht të pavlefshme licencën nr.063/FML për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Armonia”, duke i lënë subjektit një afat 30 prej ditësh për të parashtruar pretendimet e tij lidhur me vendimin e mësipërm. Rezulton se subjekti nuk ka paraqitur asnjë pretendim.

Gjatë periudhës së licencimit të subjektit radiofonik privat “Radio Armonia” nga inspektimet e herëpashershme për kontrollin e spektrit të frekuencave ka rezultuar se operatori në fjalë nuk është gjetur në transmetim.

Licenca e subjektit radiofonik privat vendor “Radio Armonia” ka përfunduar në datën 30.5.2008.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21, nenit 25 dhe nenit 33 pika 1, të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr.738, datë 29.9.2008 të KKRT-së,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën me nr.063/FML, të subjektit radiofonik privat vendor “Radio Armonia”.
 2. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM

Nr.139, datë 28.3.2011

MBI PAVLEFSHMËRINË E LICENCËS SË SUBJEKTIT RADIOFONIK PRIVAT VENDOR “RADIO PRESPA”

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, i përbërë nga:

Endira Bushati	kryetare
Alban Karapici	zëvendëskryetar
Suela Musta	anëtare
Sami Neza	anëtar
Gent Ibrahim	anëtar (në mungesë)
Zylyftar Bregu	anëtar

Pasi mori në shqyrtim çështjen me:

OBJEKT: Mbi pavlefshmërinë e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Prespa”.

BAZA LIGJORE: Neni 7, pika 21, neni 25 dhe neni 33, pika 1 e ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr.767, datë 30.1.2009 “Mbi pavlefshmërinë e licencës së subjektit radiofonik privat vendor “Radio Prespa”.

VËREN SE:

KKRT-ja me vendimin nr.108, datë 29.8.2002, ka licencuar subjektin z.Llazi Nikolla, si operator vendor radio FM private në fushën e transmetimeve radiofonike tokësore me modulim në frekuencë për një periudhë prej 3 vjetësh, për të mbuluar me sinjal komunën Liqenas. Në mbështetje të nenit 25 të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998, të ndryshuar: “Kërkesa për rinovimin e licencës bëhet 90 ditë përpara përfundimit të saj, Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit vendos për rinovimin ose për shpalljen e konkurrimit të kandidatave të reja nëse i licencuari nuk ka qenë i rregullt në zbatimin e këtij ligji”.

Me shkresën nr.510 prot., datë 16.6.2008, KKRT-ja ka njoftuar subjektin radiofonik vendor privat “Radio Prespa” se nëse dëshiron të vazhdojë veprimtarinë për të cilën është licencuar, duhet të paraqesë kërkesën së bashku me dokumentacionin për rinovimin e licencës deri në datën 15.7.2008.

Në mungesë të shfaqjes së interesit, KKRT me vendimin nr.767, datë 30.1.2009, ka vendosur të bëjë paraprakisht të pavlefshme licencën nr. 037/FML për subjektin radiofonik privat vendor “Radio Prespa”, duke i lënë subjektit një afat prej 30 ditësh për të parashtruar pretendimet e tij lidhur me vendimin e mësipërm. Rezulton se subjekti nuk ka paraqitur asnjë pretendim dhe nuk ka depozituar dosje për rinovimin e licencës.

Licenca e subjektit radiofonik privat vendor “Radio Prespa” ka përfunduar në datën 10.9.2008.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Kombëtar i Radios dhe Televizionit, në mbështetje të nenit 7, pika 21, nenit 25 dhe nenit 33 pika 1, të ligjit nr.8410, datë 30.9.1998 “Për radion dhe televizionin publik e privat në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimit nr.738, datë 29.9.2008 të KKRT-së,

VENDOSI:

1. Të bëjë të pavlefshme licencën me nr.037/FML, të subjektit radiofonik privat vendor “Radio Prespa”.
 2. Subjekti sipas pikës 1 të ndërpresë menjëherë transmetimin.
 3. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë në përputhje me Kodin e Procedurës Civile, kreu “Gjykimi i mosmarrëveshjeve administrative”.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARE
Endira Bushati

VENDIM

Gjykata e Rrethit Gjyqësor Kukës, me vendimin nr.94, datë 23.3.2011, ka vendosur shpalljen të vdekur të shtetasit Ilir Driza, i biri i Ademit dhe i Naxhijes, i datëlindjes 1971.

Abonimet vjetore për Fletoren Zyrtare mund të bëhen pranë Postës Shqiptare ose pranë Qendrës së Publikimeve Zyrtare, në adresën: Bulevardi “Gjergj Fishta”, mbrapa ish-ekspozitës “Shqipëria Sot”, tel: 04 24 27 007.
Çmimi i abonimit pranë Postës Shqiptare, për Fletoret Zyrtare 2011, është 16 000 lekë.
Çmimi i abonimit në QPZ është 14 000 lekë pa detyrimin e shpërndarjes në adresa.

BOTIMET E QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

KODI CIVIL	360 lekë
KODI I FAMILJES	310 lekë
KODI I PROCEDURAVE ADMINISTRATIVE	90 lekë
KODI PENAL USHTARAK	55 lekë
KODI I PUNËS	140 lekë
KANONI I ZHURISË	40 lekë
PËRMBLEDHJE E VENDIMEVE TË GJYKATËS EUROPIANE	328 lekë
PËR TË DREJTAT E NJERIUT KUNDËR SHQIPËRISË	
PËRMBLEDHJE PËR KTHIMIN DHE KOMPENSIMIN E PRONAVE	140 lekë
PËRMBLEDHJE VENDIMESH UNIFIKUESE TË GJYKATËS SË LARTË	512 lekë

Hyri në shtyp më 5.5.2011
Doli nga shtypi më 7.5.2011

Tirazhi: 1700 copë

Formati: 61x86/8

Shtypshkronja e Qendrës së Publikimeve Zyrtare
Tiranë, 2011

Çmimi 38 lekë